

VENDIM
Nr.894, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË
DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA
KONISPOL, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Konispol, të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 8 (tetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore, etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Bashkia **Konispol**

Fusha e përdorimit të pronës: pylje, kullota

Nr. Rend.	Nr. i Inv sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	72	Ek.Pyj. "Konispol"	Bluar	72	P.Prodhues	20	L.punimi	D.P.P.K.	D.SH.P.	
2	73	Ek.Kull. "Stillo-Vrine"	Çuka e Artolit	14/1	Kullote	70	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
3	74	Ek.Kull. "Konispol"	Proi i Mjalcës	44	Kullote	145	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
4	75	Ek. Kull. "Konispol"	Arat e Gjokajve	45	Kullote	240	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
5	76	Ek. Kull. "Konispol"	Arat e Tasos	46	Kullote	135	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
6	77	Ek.Kull. "Konispol"	Bregu i Shqipeve	4	Kullote	11	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
7	78	Ek. Kull. "Konispol"	Faqe e Blarit	52	Kullote	76	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	
8	79	Ek. Kull. "Konispol"	Proi i Gjonit	53	Kullote	11	Kullote	MMPAU	D.SH.P.	

Njësia e qeverisjes vendore: Bashkia Konispol

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
72-79	Pyjll, kullotë etj.	Në pronësi